



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME**

Numri i lëndës: 2019:264343  
Datë: 24.01.2025  
Numri i dokumentit: 06755542

ARJ.nr.151/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Delushe Halimi kryetare, Ragip Namani dhe Milena Djeric anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “E.” Sh.P.K me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A. A., kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ - vendimit të paditurës nr.01.3.2.2/752, të datës 18.11.2019, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.635/22, të datës 05.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23 janar 2025, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi “E.” Sh.P.K me seli në P., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.635/22, të datës 05.12.2023.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.635/22, të datës 05.12.2023, është vendosur si në vijim: Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit, “E.” Sh.PK me seli në P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.340/19, të datës 04.10.2021, Vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.635/22, të datës 05.12.2023, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të NDRYSHOHET aktgjykimin i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.635/22, të datës 05.12.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje

Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.340/19, të datës 04.10.2021, ashtu që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, dhe të detyrohet e paditura që t'ia kthej paditësit mjetet e paguara në shumën prej 47,690.09 euro me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 07.03.2019, e deri në përmbushjen e plotë të këtij detyrimi, ose të ANULOHET aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.635/22, të datës 05.12.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.340/19, të datës 04.10.2021, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës Dogana e Kosovës, nr.01.3.2.2/752 të datës 18.01.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, "E." Shpk me seli në P., të ushtruar ndaj aktvendimit nr.03.1.1-2018-559-1 të datës 29.11.2018, të Sektorit për Kontroll Pas Importues, si e pa bazuar.

Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Dogana e Kosovës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.340/19, të datës 04.10.2021, ka vendosur si në vijim: REFUZHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit "E." Shpk, me seli në P., me të cilën ka kërkuar që të anulohet Aktvendimi nr.01.3.2.2/752 i datës 18.11.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kthej mjetet e paguara në shumë prej 47,690.09€ me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 07.03.2019 e deri në përmbushjen e plotë të këtij detyrimi. Mbetet në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës 01.3.2.2/752, i datës 18.01.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit respektivisht vërtetimit dhe sqarimit të faktit nëse malli i llojit "Vaj Sallate Dhërmiu" i zhdoganuar nga paditësi gjatë periudhës 2016-2018 sipas DUD-ave përkatës në bazë të nomenklaturës së mallrave të TARIK-ut dhe ligjeve të zbatueshme në Kosovë klasifikohet në kodin tarifor në numër 1., siç është deklaruar nga paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallrave apo klasifikohet në kodin tarifor me numër 1., siç e ka klasifikuar e paditura me aktvendimin me nr.03.1.1-2018-559-1 të datës 29.11.2018, bazuar në mendimin për Klasifikim Tarifor 04/1.2 nr.155/20.11.2018, gjykata në seancën gjyqësore të datës 02.03.2021 duke vepruar sipas propozimit të përfaqësueses së autorizuar të paditësit që të bëhet një ekspertizë, ka caktuar

ekspertin e pavarur për klasifikimin tarifor të mallrave Shukri Hoxha për ta kryer ekspertizën për arsye se gjykata nga web faqja e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë ka vërejtur se ky institucion nuk zhvillon analiza për përcaktimin e kodeve tarifore të mallrave, prandaj meqenëse në listën e ekspertëve të përhershëm të emëruar nga gjykata nuk kishte ekspert gjyqësor profesionist të fushës i cili ka njohuri lidhur me klasifikimin tarifor të mallrave gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 358.3 të LPK-së, dispozitë kjo e zbatueshme përshtatshmërisht në kuptim të nenit 63 të LKA-së, në këtë rast vendosi që ta caktoj ekspertin e pavarur të përmendur më lartë. Nga vlerësimet dhe konstatimet e nxjerra në ekspertizën e pavarur të datës 18.03.2021, të dorëzuar në gjykatë dhe të paraqitura edhe në seancën gjyqësorë të datës 21.04.2021, nga ana e ekspertit të pavarur Sh. H. për detyrat e dhëna në ekspertizë është dhënë konstatimi se mendimi për klasifikim tarifor 0.. i datës 20.11.2018, nuk përmban asnjë provë materiale me të cilin do të vërtetohej klasifikimi i mallit në pozicionin tarifor 1..., Sipas ekspertit nuk plotësohen kërkesat nga numri tarifor 15, 16 ku taksativisht është përcaktuar se çfarë trajtimi kimiko-fizik duhet të nënshtrohet produkti që klasifikohet në këtë numër tarifor (procesi i hidrogjenizimit tërësisht apo pjesërisht, i intersterfikimit, i riesterfikimit apo i elaidinifikimit). Po ashtu sipas ekspertizës edhe dokumentacioni përcjellës dhe mostra dhe tiketa e produktit nuk përmbajnë asnjë të dhënë për trajtimet kimiko-fizike që kërkohen për klasifikimin tarifor të mallit të numrit tarifor 15.16 dhe se për klasifikimin e saktë të këtij produkti duhet të duhen të dhëna shtesë që mund të sigurohen vetëm pas analizave laboratorike.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, nenit 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Në arsyetim thekson të aktgjykimit të saj ndër të tjera thekson se: Dhoma e Shkallës së Dytë, e miraton si të drejtë dhe ligjor, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sepse nga dëshmitë e administruara ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim, pasi që edhe pas ekspertizës të ekspertit të pavarur ishte e pa mundur vërtetimi i faktit nëse malli i llojit “Vaj Sallate Dhërmiu” i zhdoganuar nga paditësi gjatë periudhës 2016-2018 sipas Deklaratave Unike Doganore përkatëse, në bazë të nomenklaturës së mallrave të TARIK-ut dhe ligjeve të zbatueshme në Kosovë klasifikohet në kodin tarifor me numër 1., siç është deklaruar nga paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallrave po klasifikohet në kodin tarifor me numër 1., siç e ka klasifikuar e paditura me aktvendimin me nr.03.I.1-2018-559-I të datës 29.11.2018,

gjykata në seancën e datës 21.04.2021 ka aprovuar propozimin e përfaqësuese së autorizuar të paditësit që të obligohet e paditura që të kryej analizat laboratorike të mallit lëndor, për të përcaktuar saktë kodin tarifor. Gjykata nga dispozitat e nenit 21 të UA nr.25/2016 për marrjen e Mostrave, Dokumentacionit të Mallit dhe Trajtimin e Tyre në Procedurë Doganore nr.25/2016 ku parashihet se e paditura laboratorit i saj zhvillon analiza laboratorike për ti caktuar parametrat e kërkuar dhe se nëse Sektori i Laboratorit nuk mund të kryej analizën laboratorike, përmes njësitit kompetent në Doganë, mostra bashkë me urdhëresën do të dërgohen në njërin nga entet e certifikuara laboratorike konform legjislacionit në fuqi e ka obliguar të paditurën që në afat prej 15 ditësh për mallin lëndor "Vaj Sallate 9600" të deklaruar në procedurë të zhdoganimit tek e paditura sipas DUD-ave kontestues, sipas mostrës së marr nga e paditura, të blombuar me nr.1., që ti bëj analizën kimike - fizike - teknologjike, për të përcaktuar nëse malli lëndor i është nënshtruar procesit të hidrogjenizimit tërësisht apo pjesërisht, i interesterifikimit, i riesterifikimit apo i elaidinifikimit, duke i dhënë mundësinë që në qoftëse e paditura nuk është në gjendje të kryej vet një analizë të tillë përmes laboratorit të saj atëherë ta dërgoj mostrën e marr të mallit lëndor ta dërgoj për analizë në njërin nga entet e certifikuara laboratorike konform legjislacionit në fuqi, siç parashihet me dispozitat e UA nr.25/2016 për Marrjen e Mostrave, Dokumentacionit të Mallit dhe Trajtimin e Tyre në Procedurë Doganore nr.25/2016. E paditura përmes parashtrësës së dorëzuar në gjykatë të datës 13.09.2021 e paditura i ka dorëzuar gjykatës rezultatet laboratorike, përkatësisht Raportin e Analizave Laboratorike për mallin lëndor "Vaj Olive Dhërmiu" të datës 17.06.2021 të Agjencisë Kombëtare Doganore të Bullgarisë, si dhe shkresën e pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Doganore të Bullgarisë për Drejtorin e Përgjithshëm të Doganës së Kosovës të datës 01.07,2021, të përkthyer në gjuhën shqipe, e që gjykata konstatoj se ky laborator ka analizuar mostrën e mallit lëndor "Vaj Olive Dhërmiu" me kodin laboratorik 3., sipas blombës me m. 1., dhe ka zhvilluar analizat fizike-kimike-teknologjike për këtë mall, prej nga është ardhur në përfundim se bazuar në vlerësimin e ekspertëve të rezultatit të testit dhe informatave në dispozicion në pajtim me kushtet në kapitullin 15 të Nomenklaturës së kombinuar, mostra e analizuar e regjistruar me kodin laboratorik 3047 21 (Olive Oil Dhërmiu) është identifikuar si përzierje e ngrënshme e vajrave bimor.

Kolegji, shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtën e refuzon si të pa bazuar dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton se nga shkresat e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Doganore të Bullgarisë për Drejtorin e Përgjithshëm të Doganës së Kosovës e datës 01.07.2021 gjykata e ka konstatuar faktin se përmes kësaj shkrese Agjencia Kombëtare Doganore e Bullgarisë duke i'u përgjigjur Doganës së Kosovës me letrën me nr.I. 0., për asistencë administrative, mbi analizat kimike-teknologjike, e ka informuar të paditurën se pas të gjitha testeve të kryera produkti "Olive Oil Dhërmiu" përshkruhet si lëng vajor i pastër homogjen me ngjyrë të verdhë të zbehur dhe nuancë të hapur të gjelbër. Në këtë shkresë thuhet se bazuar në përbërjen e saj me acide yndyrore tri gliceride dhe vlera jodi, mostra e analizuar është identifikuar si përzierje e vajit të ullirit dhe vaj të lule diellit dhe se sipas vetive psiko-kimike përfshirë spektrin infra red, produkti nuk është modifikuar në mënyrë kimike. Prandaj duke marr parasysh rezultatet e testit, produkti i analizuar "Olive Oil Dhërmiu" është përzierje e rafinuar e zbardhur dhe aromatizuar e vajrave bimor, të përshtatshëm për konsum nga njerëzit. Në shkresë është konstatuar se bazuar në kriterin objektiv

të produktit dhe sipas Rregullave të Përgjithshme për Interpretim I dhe 6 të Nomenclaturës së Kombëtare për Bashkimin Evropian dhe në vijim Shënimet Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar për kreun 1517 "Olive Oil Dhërmu" klasifikohet nën kodin NK 1., "Vajra fiksuara bimore, lëngje të përziera" dhe se produkti në fjalë nuk mund të klasifikohet si vaj bimor nga kreu 1516 pasi që nuk ka kaluar nëpër trajtime modifikuese siç është hidrogjenizimi (i pjesshëm ose i plotë), inter-esterifikimi, ri esterifikimi ose elaidinizimi.

Pretendimet ankimore të paditësit, nga shkaqet ankimore të cekura si më lartë, si dhe theksimet e tjera si në arsyetim, kolegji i shqyrtoi në baza ligjore dhe i refuzon si të paqëndrueshme dhe me ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës administrative të LKA-së, apo të LPK-së, ligj i zbatueshëm, e po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë sipas çështjes në shqyrtim. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimi të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë me që aktgjykimet e kontestuar nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuar përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pa bazuar të kërkesëpadsisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimi të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Dogana e Kosovës, nr.01.3.2.2/752 të datës 18.01.2019, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, "E." Sh.P.K me seli në P., të ushtruar ndaj aktvendimit nr.03.1.1-2018-559-1 të datës 29.11.2018, të Sektorit për Kontroll Pas Importues, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Pretendimet e paditësit, të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera thekson se: gjykata me aktgjykim ka vërtetuar se vaji objekt i kërkesëpadsisë nuk përputhet as me kodin e përcaktuar nga eksportuesi sipas DUD-ve, as me kodin e caktuar sipas vendimit të paditurës, as me kodin e përcaktuar nga ekspertizat-rezultatit të laboratorit dhe prapëseprapë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, si dhe se gjykata sipas detyrës zyrtare është dashur të propozoj superekspertizë..., kolegji i Gjykatës Supreme, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoi në tërësi si të pabazuara.

Aktgjykimi i kontestuar nuk rezulton as me shkelje të dispozitave të procedurës nga neni 182 par.2 pika n) dhe o), nenit 7 par.2 të LPK-së, si dhe nenit 26 par. 1 dhe 2 të LKA-së, ashtu siç pretendon paditësi në kërkesën e tij. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Nga gjendja faktike e konstatuar, rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, KDAK-së.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË  
ARJ.nr.151/2024, më datë 23 janar 2025

B. Profesionale  
Zanë Buçinca

Kryetare e Kolegjit  
Delushe Halimi